



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 84, Datë 19.03.2026

MBI

**DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË
SHOQËRISË “SA-GLE KOMPANI” SH.P.K. SI MJET PËR GARANTIMIN E
DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE**

Në mbështetje të nenit 16 të, ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 9, pika 8, dhe 10, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.03.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 316/11 prot., datë 18.03.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, “Mbi kërkesën e shoqërisë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k. për dhënie autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “First Investment Bank-Albania” sh.a.”,

Konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie autorizimit për shoqërinë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për Marrjen e Autorizimit

- Shoqëria “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k., është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 123, datë 29.08.2012 në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën nr. 316 prot., datë 23.01.2026, shoqëria ka paraqitur aplikim/dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “First Investment Bank-Albania” sh.a.

2. Shqyrtimi i Kërkesës dhe Kërkesa për Dokumentacion Plotësues

- ERE nëpërmjet shkresës nr. 316/2 prot., datë 05.02.2026 dhe e-mailit datë 05.02.2026, ka njoftuar shoqërinë dhe bankën për zhvillimin e një seance dëgjimore në datë 12.02.2026, duke i evidentuar gjithashtu depozitimin e informacionit /dokumentacionit të konstatuar të munguar në këtë aplikim.
- Në vijim, ERE i dërgoi shoqërisë dhe bankës shkresën nr. 316/8 prot., datë 18.02.2026 si dhe nisi e-maillet rikujtesë në datat 20.02.2026 dhe 06.03.2026, ku i risolli në vëmendje si bankës ashtu dhe shoqërisë se duhet të përcjellë deklaratën përkatëse nga banka financuese.
- Shoqëria/banka me shkresat nr. 316/5 prot., datë 12.02.2026, nr. 316/6 prot., datë 17.02.2026 dhe nr. 316/10 prot., datë 12.03.2026 ka depozituar të plotë dokumentacionin e kërkuar.

3. Përfundime dhe Kërkesa të tjera për Dhënien e Autorizimit

- Nga analiza e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollojnë interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollojnë interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, si vijon:
- **Neni 5, pika 2** - Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë, në përputhje me kërkesat e Rregullores.

4. Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- **Neni 5, pika 4** - Dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose fotokopjoje të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike.
- **Neni 5, pika 5** - Shoqëria kërkon që të mbahet konfidencial informacioni lidhur me kontratën e kredisë/ akteve pas vijuese të saj dhe çdo informacion tjetër financiar/ tregtar që gjendet në dokumentacionin e vënë në dispozicion, duke qenë se përbëjnë të dhëna financiare-tregtare/ konfidenciale të shoqërive, si dhe të dhëna personale sensitive të nënshkruesve të akteve, të cilat nuk përbëjnë interes parësor dhe thelbësor për palë të treta, përveç institucioneve të përfshira në këtë proces shqyrtimi.

Për sa kërkuar nga shoqëria në lidhje me trajtimin me konfidencialitet të dosjes së aplikimit, është bërë trajtimi i dokumentacionit në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar, dhe “*Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial*”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 65, datë 26.03.2018, ku është klasifikuar dokumentacioni i cili konsiston në trajtim tërësisht konfidencial apo dokumentacion i cili ka identifikimet përkatëse si konfidenciale, duke zbatuar parimin e kufizimit proporcional (pra, klasifikim vetëm për ato pjesë ku ka bazë ligjore dhe nevojë reale për mbrojtje).

Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar, duke qenë se përmbajnë të dhëna identifikuese të personave fizikë, si dhe informacione të aktivitetit tregtar, justifikojnë trajtimin si konfidencial, dokumentacioni si vijon:

- Shkresa e shoqërisë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k., datë 21.01.2026 me lëndë: “*Kërkesë për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të të licencuarit si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve*” dhe shkresa e datës 12.02.2026 me lëndë: “*Vënie në dispozicion dokumentacioni*” (Do të konsiderohen konfidenciale vetëm të dhënat personale të administratorit, si dhe informacione të aktivitetit tregtar të shoqërisë),
- Fotokopje e noterizuar e regjistrit të Barrëve Siguruese (Ky dokument do të konsiderohet si konfidencial, duke qenë se përmban të dhëna sensitive të shoqërisë, si dhe informacione mbi aktivitetin tregtar të shoqërisë).
- Autorizimi i datës 12.02.2026, për Znj. N. B. për të marrë pjesë në seancën dëgjimore të zhvilluar. (Ky dokument do të konsiderohet konfidencial në lidhje me të dhënat identifikuese të tilla si emër, mbiemër, nr. i ID, adresën e banimit, datëlindjen dhe nr. personal)
- Kontratë Kredie Bankare nr. 3185 rep., nr. 1138 kol., datë 19.09.2022 (Ky dokument do të konsiderohet si konfidencial, duke qenë se përmban termat e një marrëdhënieje garancie dhe përfshin: kushte financimi, detaje të kontratave të kredisë, risk kreditor, klauzola sigurimi, detyrime të palëve, të cilat janë të dhëna me natyrë ekonomike/kontraktuale që mund të dëmtojnë interesat e subjektit/palëve të treta nëse publikohen)

- Kontrata e Koncesionit nr. 2901 rep., nr. 395 kol., datë 14.09.2009, e nënshkruar ndërmjet shoqërisë dhe MIE-s (Ky dokument do të konsiderohet si konfidencial, duke qenë se përmban informacione të konsideruara si sekrete tregtare, të tilla si plane financiare, modele biznesi, kosto operative, strategji investimi, të cilat mbrohen nga ligji, si dhe për të ruajtur interesin ekonomik të shoqërisë).
- Nga ana tjetër, do të konsiderohet dhe trajtohet si jokonfidencial, për arsye se janë dokumente me karakter deklarativ/informues dhe/ose është e depozituar apo e aksesueshme pranë institucioneve publike kompetente, dokumentacioni si vijon:
 - Ekstrakti i regjistrit tregtar i shoqërisë SA-GLE KOMPANI sh.p.k. (Ky dokument do të konsiderohen si jokonfidenciale, në rrethanat që janë të publikuara dhe të aksesueshme pranë institucioneve publike kompetente, në rastin konkret QKB);
 - Marrëveshje siguruese (Marrëveshje Kolaterali Financiar) nr. 3187 rep., nr. 1140 kol., datë 19.09.2022, mbi barrësimin e 100% të kuotave të shoqërisë dhe Marrëveshje siguruese nr. 3186 rep., nr. 1139 kol., datë 19.09.2022, mbi vendosjen 100% të kuotave (Marrëveshjet Siguruese të sipërpërmendura do të konsiderohen jokonfidenciale, por me redaktim selektiv të elementeve që kanë të dhëna financiare sensitive dhe të dhëna personale).
 - Kontratë Shitje Pasuri e luajtshme me nr. 9473 rep., nr. 3091 kol., datë 09.11.2021. (Ky dokument do të konsiderohet si jokonfidencial, por me redaktim selektiv, për arsye se konsiderohet si një dokument me natyrë juridike deklarative dhe lidhet me ndryshimin e pronësisë së kuotave, informacion i cili reflektohet dhe në regjistrin tregtar).
 - Vendimi i datës 19.09.2022, i Ortakut të Vetëm të shoqërisë SA-GLE KOMPANI sh.p.k. AG Hpower & Construction sh.p.k.; Vendimi i datës 19.09.2022 i Ortakut të Vetëm të shoqërisë “AG Hpower & Construction” sh.p.k.; Vendimi nr. 28, datë 25.10.2021, i Ortakëve të Shoqërisë “ENRIKU” sh.p.k.; Vendim nr. 7, 25.10.2021, i Ortakëve të shoqërisë “AG Hpower & Construction” sh.p.k.; Vendim nr. 12, datë 25.10.2021, i Ortakëve të shoqërisë Koncesionare “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k., (Këto dokumente do të konsiderohen jokonfidenciale, por me redaktim selektiv të elementeve që kanë të dhëna financiare sensitive dhe të dhëna personale).
 - Deklarata e administratorit e datës 21.01.2026, mbi kuotat e shoqërisë që nuk janë barrësuar dhe deklarata e administratorit e datës 12.02.2026, mbi vullnetin për të zbatuar çdo akt ligjor në fuqi (Këto dokumente përbëjnë akte të brendshme deklarative, që lidhen me organizimin dhe vendimmarrjen e shoqërisë. Ato nuk përmbajnë në vetvete sekret tregtar apo informacion financiar të ndjeshëm, ndaj konsiderohen dokumente me natyrë jokonfidenciale, por me redaktim selektiv të elementeve që kanë të dhëna financiare dhe personale).
 - Deklarata e lëshuar nga banka e datës 11.03.2026, mbi gatishmërinë e vullnetin për të zbatuar çdo akt ligjor në fuqi (Ky dokument do të konsiderohet si jokonfidencial, por me redaktim selektiv të elementeve që kanë të dhëna financiare sensitive dhe të dhëna personale).
 - Shkresa e MIE nr. 7466/2 prot., datë 24.12.2021, me lëndë: Miratohet transferimi i kapitalit të shoqërisë koncesionare “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k., si dhe shkresa drejtuar MIE-s me nr. 299 prot., datë 14.12.2011 ku njofton për fazën e miratimit të kredisë (Këto dokumente do të konsiderohen si jokonfidencial, duke qenë se nuk përmbajnë të dhëna personale apo të aktivitetit tregtar që mund të dëmtojnë shoqërinë në rast publikimi).

5. Plotësimi i Kërkesës sipas nenit 8:

- **Pika 1** - Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, arsyet për vendosjen e barrës siguroese, përshkrimi i detyrimeve dhe deklarata mbi statusin e kuotave.
- **Pika 2** - Janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror si më poshtë vijon:
 - **Gërma “a”** - Ekstrakti historik i regjistrit tregtar.
 - **Gërma “b”** - Vendimi i organeve drejtuese: Është depozituar Vendimi i Ortakut të Vetëm të shoqërisë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k., nr. 3183, datë 19.09.2022, me anë të së cilës është shprehur dakordësia mbi vendosjen e 100% të kuotave të kësaj shoqërie si garanci për shlyerjen e detyrimit ndaj “Banka e Parë e Investimeve-Albania” sh.a.
 - **Gërma “c”** - Marrëveshjet përkatëse:
 - “Kontratën e Kredisë” nr. 3185 rep., nr. 1138 kol., datë 19.09.2022, nënshkruar midis palëve, ku qëllimi i përdorimit të kredisë është: *Përmblotja e detyrimeve të kredisë që kredimarrësi ka pranë “Credins Bank” sh.a., që është përdorur për investime në HPP.*
- **Pika 3** - Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

6. Kushtet e Vendosura për Dhënien e Autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga kuadri ligjor ose nga marrëveshjet kontraktuale në fuqi.

Vendosja e këtij kushti bëhet për të garantuar se autorizimi i dhënë nga ERE mbetet i kufizuar vetëm në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore, pa ndërhyrë apo anashkaluar detyrimet ligjore ose kontraktuale që mund të ketë shoqëria ndaj autoriteteve të tjera ose palëve të përfshira në marrëdhënie financiare apo tregtare. Në këtë rast, duke qenë se marrëveshja është nënshkruar me bankë vendase, është përgjegjësi e shoqërisë të respektojë çdo detyrim tjetër jashtë kompetencës së ERE-s që mund të rrjedhë nga këto marrëveshje.

- Në referencë të nenit 9, pika 8 të Rregullores, ku citohet se shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar, ku të reflektohet ndryshimi vendosja e kolateralit mbi kuotat e saj, vlen të sqarojmë se shoqëria e ka një veprim tashmë të ezauruar/pasqyruar, si e tillë nuk lind e nevojshme të mbahet në konsideratë në vijim, gjithmonë në rastin e dhënies së autorizimit nga ERE.
- Shoqëria detyrohet të njoftojë ERE-n **në rast të heqjes së barrës siguroese ose të ekzekutimit të saj të detyrueshëm.**

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k. si mjet për të garantuar përmblotjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “First Investment Bank-Albania” sh.a. (sipas kontratës së kredisë nr. 3185 rep., nr. 1138 kol., datë 19.09.2022).

2. Dhënia e autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
3. Shoqëria “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.
4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në zbatim të pikës 2 dhe 3, si dhe në rast se nga MIE depozitohet një qëndrim ndryshe në lidhje me detyrimet që i burojnë shoqërisë nga kontrata e nënshkruar datë 14.09.2009, apo në rast të depozitimit të dokumentacionit të ndryshëm nga ai që i ka shërbyer kësaj vendimmarrje.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI